



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHKODËR**

---

Nr \_\_\_\_\_ prot

Shkodër më \_\_\_\_\_ 2021

Lënda: Dërgim informacioni.

**Z.** \_\_\_\_\_

Në përgjigje të tuajës nr. 18762 prot dt. 27.10.2021 , ju dërgojmë informacionin e kërkuar për masat e marra për përballimin e situatave të mundshme nga rreshjet gjatë periudhës së stinës së dimrit.

Bashkia Shkodër në zbatim të nenit 11 të Ligjit nr 45/2019 “ Për mbrojtjen civileka hartuar “Planin e Masave për parandalimin dhe përballimin e situatave që mund të krijohen nga përmytjet dhe izolimit nga dëbora”. Plani parashikon qëllimin dhe objektivat si edhe aktivitetet që do të ndërmerren nga Bashkia Shkodër për arritjen e tyre.

Plani parashikon masat paraprake dhe veprimet që duhet të kryhen në situatat emergjente që mund të krijohen gjatë stinës së dimrit si pasojë e rreshjeve të shumta të shiut dhe dëborës.

**Përsa i përket parandalimit dhe përballimit të situatave nga dëbora janë marrë masat si më poshtë:**

Janë realizuar punimet për mirëmbajtjen rruga Ura e Mesit-Prekal – Kir –Mali Shoshit – Breglumi-Ndërlisaj-Thethë, njësia administrative Postribe-Pult –Shosh-Shalë.

Është realizuar blerja e 40 ton kripë e zezë për përballimin e emergjencave në rastet e borës dhe ngricave. Kjo sasi është gjëndje në bashki për përballimin e nevojave për mbajtjen hapur të rrugëve rurale dhe urbane.

Është lidhur kontrata me objekt “Shërbime për mirëmbajtje emergjente të rrugëve të qytetit dhe të Njesive Administrative (fushore)” ku janë parashikuar ndërhyrjet si më poshtë:

*Në zonat fushore:*

- Janë në dispozicion dy borëpastruese për hapje rruge nga bora për realizimin e 320 orë pune, të cilat cilat janë parashikuar të ndërhyjnë në qytet dhe në njësitë administrative fushore për krijimin e kushteve të lëvizjes në një kohë sa më të shpejtë të njerëzve dhe mjeteve.

*Në zonat malore:*

- Janë në dispozicion dy eskavator për punime hapje rruge në raste emergjencash 320 orë pune.
- Është në dispozicion një fadromë për punime hapje rruge në raste emergjencash 160 orë pune.

Me këto 3 mjete janë parashikuar ndërhyrjet për hapjen e rrugëve në aksin Ura e Mesit-Prekal – Kir –Mali Shoshit –Breglumi-Ndërlytaj-Thethë, që përfshin njësitë administrative Postribë-Pult –Shosh-Shalë. Punimet e parashikuara janë zhblokimi i rrugëve nga dëbora në të gjithë aksin si dhe hapjen e rrugëve dhe riparimin e pasojave nga rreshqitjet e materialeve si gurë, dhera etj.

Me këto masa i kemi paraprirë ndërhyrjeve në kohë për hapjen e rrugëve nga bora për të bërë të mundur zvogëlimin e kohës së izolimit për banorët e këtyre zonave.

Rruga Qafë Thore-Theth është në administrim të operatorit sipërmarrës që po realizon investimin me fonde të FSHZH-së.

Përvec masave të mësipërme Bashkia Shkodër ka në gadishmëri teknike edhe mjetet si më poshtë:

- Eskavator me zinxhir në administrim të Drejtorisë së Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore pranë Bashkisë Shkodër, copë 2.
- Fadroma me goma në administrim të Bashkisë Shkodër, copë 2.
- Fadroma me goma copë 3, kamion 7 ton copë 1, 3 kamionçina copë 3 të cilat janë në administrim të Ujësjiellës Kanalizime Sh.a pranë Bashkisë Shkodër .

**Përsa i përket parandalimit dhe përballimit të situatave të përmytjeve janë marrë masat si më poshtë:**

Gjatë vitit 2021, deri në fund të muajit Shtator, Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP dhe Drejtoria e Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore ( si institucion varësie) ka ushtruar veprimtarine në realizimin e objektivave për përmirësimin e sistemit vendor dhe kullimit mbështetur në Planin e Veprimit për ndërhyrje në sistemin kullues.

Kështu janë hartuar projektet teknike për kanale kulluese dhe përfunduar ndërhyrja e pastrim/mirëmbajtje për 98 kanale kullues të dytë dhe të tretë. Gjatësia totale e ndërhyrjes është 75.25 km me një sipërfaqe të përmirësuar kullimi prej 2380 Ha dhe volum punimesh prej 128.320 m<sup>3</sup>, këto të ndarë si më poshtë:

Nr.	Njësia Administrative	Ndërhyrje (Km)	Fshatra ku është ndërhyrë
2	Nj.A. Bërdicë	32.6	Bërdicë e Sipërme, Trush, Bërdicë e Mesme, Bërdicë e Madhe
4	Nj.A. Velipoje	42.65	Reç i Ri, Luarzë, Velipojë
<b>TOTAL</b>		<b>75.25</b>	

Është realizuar pastrimi i përroit të Oblikës nga bashkia nga mbetjet urbane dhe inerte të hedhura nga banorë e subjekte të ndryshme në brigjet e përroit. Situata monitorohet në vazhdimësi pasi megjithë ndërhyrjet e herëpashërëshme mbetet zonë problematike.

Është realizuar pastrimi i bregut të liqenit nga mbetjet e ndryshme të grumbulluara në brigjet e tij dhe situata monitorohet në vazhdimësi.

Për sigurimin e kushteve për popullsinë në rast evakuimi, Bashkia Shkodër ka përcaktuar vend akomodimet me kapacitete prej rreth 550 shtretër.

Përsa i përket gjësë së gjallë, në bashkëpunim me Inspektoriatin Rajonal të Veterinarisë janë hartuar listat e fermerëve që mbarështrojnë blegtori, numri i krerëve dhe lloji i tyre për të gjitha fshatatrat që janë të rrezikuara nga përmytjet.

Nga ana e Bashkisë Shkodër disponohet në gjendje nje sasi prej 75 ton ushqime për blegtorinë ( të imëta, derra, gjedh).

Për rastet e emergjencës për evakuimin e gjësë së gjallë, nga ana e Bashkisë Shkodër, janë përcaktuar vend-qëndrimet dhe caktuar personat përgjegjës për çdo Njësi Administrative.

Janë vendosur ne dispozicion vend magazinimet për pakot ushqimore si dhe funksionon struktura për magazinimin dhe shpërndarjen e tyre me grupet e punës për familjet e prekura nga fatkeqësitë natyrore

Janë marrë masat për furnizimin me ujë të pijshëm të popullsisë në zonat e përmytura me anë te autobotëve që ka në dispozicion Ujësjellës Kanalizime Shkodër (U.K.Sh.a)

Duke ju falenderuar!

**KRYETAR**

**Voltana ADEMI**

